



Projekti “Mbrotja e Mjedisit nëpërmjet Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës” – IADSA II

Thirrje për Studentët: Bashkohuni me Eko-Klubin e Gjelbër për të Ndhmuar Menaxhimin e Mbetjeve në Durrës me Ide Inovative!

Për çfarë bëhet fjalë?

Je një student/e i/e apasionuar pas çështjeve mjedisore dhe inovacionit? Bashkohu me **Eko-Klubin e Gjelbër** dhe bëhu pjesë e një eksperience unike për të ndikuar pozitivisht në komunitetin tënd!

Si anëtar i Klubit të Gjelbër, ju do të:

- ☒ Merrni pjesë në një **shkollë verore 5-ditore në Korçë** të fokusuar në menaxhimin e mbetjeve, ekonominë qarkulluese dhe inovacionin mjedisor;
- ☒ Punoni në ekipe me 4 persona për të zhvilluar **ide praktike dhe të zbatueshme** për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në qytetin e Durrësit;
- ☒ Prezantoni idetë tuaja në **sfidën e inovacionit**, ku projektet më të mira do t'i paraqiten Bashkisë së Durrësit për zbatim të mundshëm në të ardhmen;
- ☒ Fitoni **çmime dhe certifikata pjesëmarrjeje** si dëshmi e përfshirjes dhe angazhimit tuaj.

Çfarë ofrojmë?

- Trajnim dhe mentorim nga ekspertë të fushës;
- Akomodim dhe ushqim për të gjitha ditët e shkollës verore;
- Transport i mbuluar nga Durrësi dhe Tirana drejt Korçës;
- Çertifikatë pjesëmarrjeje për të gjithë pjesëmarrësit aktivë.

Çfarë lloj idesh kërkohen?

Ne kërkjmë ide kreative, të zbatueshme dhe të orientuara drejt veprimit, që adresojnë sfida reale në Durrës si:





- ◆ Reduktimi i ndotjes plastike dhe i mbetjeve urbane;
- ◆ Promovimi i riciklimit dhe praktikave të ekonomisë qarkulluese;
- ◆ Zhvillimi i zgjidhjeve komunitare për menaxhimin e mbetjeve;
- ◆ Zgjidhje urbane të qëndrueshme dhe inovative.

Kush mund të aplikojë?

- ✓ Të rinj/të reja të moshës 20–30 vjeç me banim në Durrës ose Tiranë;
- ✓ Aktualisht ndjekin ose kanë përfunduar studimet në: mjedis, inxhinieri, shkenca kompjuterike, urbanistikë, administrim biznesi ose fusha të ngjashme;
- ✓ Të interesuar për qëndrueshmërinë mjedisore dhe punën në grup.

Si të aplikoni?

- ✂ Dergo **CV-në tuaj** në: info@uri.org.al
- ✂ Mund të përdorni edhe formularin online.

Afatet e rëndësishme:

- 📅 Afati i aplikimit: **15 Maj 2025**
- ✓ Përzgjedhja e kandidatëve: **1 Qershor 2025**
- 🏠 Zhvillimi i shkollës verore: **Qershor 2025**, në qytetin e Korçës.
- ☎ Për më shumë informacion: +355 69 272 4774 | ✉ info@uri.org.al

Bëhu pjesë e ndryshimit! Ndhmo në krijimin e një Durrësi më të pastër, më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm! 🌍💡👤

